Onomatopoeia in Albanian literature

Abstract: *This paper examines onomatopoeia as one of the most expressive sound figures in Albanian literary discourse, analysing it from both phonological and semantic perspectives. Although often regarded as a peripheral element within linguistic systems, onomatopoeia in literature fulfils multiple functions. It creates atmosphere, evokes sensory experiences, enhances rhythm, increases musicality, and enriches textual expressiveness. Relying on both classical and contemporary theories of imitation and sound symbolism, the study explores the artistic potential of onomatopoeia through the analysis of selected Albanian literary works, including the poetry of Lasgush Poradeci, the short story "Klithma" by Anton Pashku, and the novel "The Dead River" (Lumi i vdekur) by Jakov Xoxa. These literary works demonstrate the role of onomatopoeia in depicting emotional states, portraying settings, and intensifying the reader's aesthetic experience. Particularly noteworthy is Xoxa's creative and vivid use of onomatopoeia, where it appears as an integrated stylistic element with rhythmic and semantic functions. The study also highlights the blurred boundary between onomatopoeia and interjection, as well as the importance of context in determining their meaning and function. Onomatopoeia, a present from children's literature to magical and socialist realism, confirms that the imitation of sound is a powerful source of vitality and figurative strength in literary texts*.

Keywords: *Onomatopoeia, Albanian Literature, Stylistic Figures, Sound Symbolism*.

Pasthirrmat, e bashkë me to edhe onomatopetë, në gramatika të ndryshme të gjuhëve të ndryshme përkufizohen si margjinale[1] në sistemin gjuhësor, madje ndonjëherë edhe si të rralla në gjuhë[2], për rrjedhojë, rëndësia e tyre në konstruktin e fjalisë është dytësore, meqë kryesisht

1 R. QUIRK, S. GREENBAUM, G. LEECH, J. SVARTVIK, *A Comprehensive Grammar of the English Language*, Longman, London-New York, 1985, 74.
L. KORTVELYESSY, *Onomatopoeia – a unique species?. Studia Linguistica* 74, no. 2:, (2020) 506–551, 8.

2 G. YULE, *The Study of Language*, Cambridge University Press, New York, 2014, 14.

ato shfaqin emocione dhe shfaqja e këtyre emocioneve, shpeshherë bëhet e qartë vetëm kur shoqërohen me pjesët e tjera të ligjëratës, gjegjësisht nga konteksti. Megjithëkëtë, në diskursin letrar manifestimet e tyre janë të shumta, duke pasur parasysh faktin se, përdorimi i pasthirrmës e afron tekstin me ligjërimin bisedor apo gjuhën e folur, veçan përmes shpërfaqjes së gjendjeve të brendshme emocionale, në mënyrë shumë direkte, të personazheve apo të narratorit, njëherësh bën edhe afrimin e tekstit më shumë me lexuesin. Po ashtu, onomatopeja përjeton manifestime të shpeshta në diskursin letrar, me ç'rast autori e aktivizon dhe e vë në plan të parë potencialin e saj tingullor, , ngaqë i shërben për ta kurdisur metrikën, dhe për rrjedhojë strukturën ritmike, në rastin e poezisë, dhe e zgjeron atë në aspektin e asaj se çka shfaq dhe shpreh. Ngaqë sipas Wharton-it[3] disa fjalë, ndonëse janë qartësisht gjuhësore, duket se bartin një element shtesë të "të shfaqurit", ku provat e ofruara për shtresën e parë të informacionit janë më të drejtpërdrejta. E shembull i qartë për këtë është gjuha onomatopeike (p.sh. *clink, clank, splash, cizzle*). Në fakt, gjuha ikonike në përgjithësi është shembull: imitime të stilizuara të tingujve jonjerëzorë (p.sh. *buzz, miaow, moo, oink*); gjithashtu, imitime të stilizuara të tingujve njerëzorë (p.sh.: *ha ha, tee hee, boo hoo, boo*). Në këta shembuj të fundit, ka një element kodimi, i cili i ndan ata nga shembujt e qartë të shfaqjes, si të qeshurit ose të qarët, por edhe një element i të shfaqurit, i cili i ndan nga shembujt e qartë të të thënit si "jam i kënaqur" apo "po qaj"[4].

Kështu, këta dy komponentë të onomatopesë, njëri më pak e tjetri më shumë, jo vetëm që i shërbejnë qëllimit të autorit për ta shprehur të kompletuar atë që ka pasur ndërmend në momentin e krijimit, por pasurohen te marrësi, i cili, në bazë të efektit që krijojnë tek ai, mund t'u mveshë kuptime dhe përfytyrime të reja. Arsyeja pse onomatopeja shfaqet aq e pasur në letërsi, buron edhe nga fakti se ajo klasifikohet te figurat letrare të tingullit dhe të intonacionit (e ngjashme me aliteracionin dhe konsonancën për nga funksioni tingullor) dhe, si e tillë, përdoret në mënyrë të qëllimshme nga autori.

Duke e analizuar poezinë "Ode to the West Wind" të Percy Shelley, në kuptim të aliteracionit, Black thotë se: Përsëritja e tingujve 's' e 'sh' sjell tingullin e erës që rrënon gjithçka para vetes. Ky efekt është, po ashtu, shembull i onomatopesë, figurë e fjalës, në të cilën tingujt e fjalëve duket sikur reflektojnë kuptimin.[5] Ndërsa, Ferberi në librin e tij "Gjuha dhe

3 T. WHARTON, *Pragmatic and Non-Verbal Communication,* Cambridge University Press, London, 2009, 99-100.

4 Ivi.

5 J BLACK. L. CONOLLY, K. FLINT, I. GRUNDY, D. LEPAN, R. LIUZZA, J. J. MCGANN, A. LAKE PRESCOTT, B. V. QUALLS, C. WATER *The Broadview Anthology of British Literature*, Vol.4 – *The Age of Romantism* - second edition, Broadview Press, Toronto, 2010, 942

poezia" (2019) shkon edhe më tej, për ta vënë edhe gjuhën, ashtu si letërsinë në kornizat e imitimit, sikurse 'mimesis' i Aristotelit, por tash duke cituar Darwin-in. "Charles Darwin-i po përsëriste një gjë të zakonshme kur në "The Descent of Man" (1871) shkroi: "Nuk mund të dyshoj se origjina e gjuhës i detyrohet imitimit dhe modifikimit të tingujve të ndryshëm natyrorë, zërave të kafshëve të ndryshme dhe klithmave instinktive të njeriut, të ndihmuara me shenja e gjestikulacione.[6] Tutje, duke shpjeguar arsyet e përdorimit të onomatopesë në letërsi e sidomos në poezi, Ferber-i thotë se onomatopeja është një nga termat teknikë që i mbajmë mend dhe i sjellin ndërmend më së lehti, ndoshta sepse janë fjalë kaq të çuditshme, të shkruara në mënyrë të çuditshme[7]. Së këndejmi, si strukturalistëë që nuk i shohin onomatopetë si pjesë organike të gjuhës[8], edhe Ferber-i i sheh ato si "të lehta për t'u kuptuar dhe argëtuese për t'u menduar". Edhe Ferber-i, ashtu si Graham-i[9], përdor edhe termin 'onomatopoetikë', duke iu referuar përdorimit të onomatopesë në poezi dhe funksionit që ajo kryen, si figurë e fjalës. Ferber-i mendon se onomatopeja përkufizohet përgjithësisht si "fjalë ose kombinim fjalësh, tingulli i së cilës duket se i ngjan shumë tingullit që tregon" për ta vazhduar përkufizimin në vazhdim në "një kuptim të zgjeruar ose më delikat, si një tipar i fjalëve që nga forma e tyre tingullore sugjerojnë çdo veçori të asaj që nënkuptojnë, jo vetëm tingullin: mund të jetë madhësia, forma, shpejtësia, qëndrueshmëria, kohëzgjatja ose pothuajse çdo gjë tjetër. Kuptimi më i gjerë mbivendoset me "simbolizmin e tingullit", termi më i përgjithshëm për lidhjen e natyrshme, ose në dukje të natyrshme, midis tingujve dhe kuptimeve ose referencave të tyre; nganjëherë quhet "ikonicitet tingullor".[10]

Duke u mbështetur në përkufizimet antike për poezinë, letërsinë, si imitim, askund më shumë se tek onomatopeja nuk gjen mbështetje imitimi si i tillë. Platoni, në veprën e tij "Kratili", përmes dialogut ndërmjet Sokratit dhe Kratilit flet për natyrën e gjuhës, duke e nxjerrë si një imitim besnik të natyrës sidomos pjesën e "fjalëve primitive", ndërkohë që të tjerat janë të mbindërtuara mbi ato baza, që sot i njohim si tema fjalëformuese. Platoni flet për herë të parë për simbolizmin tingullor, duke theksuar se vetë tingujt janë ata që bartin semantika të caktuara:

---

6 (Darwin C. (1871): 673) sipas: B. DUPRIEZ, *A Dictionary of Literary Devices*, Harvester-Wheatsheaf, New York-London-Toronto-Tokyo-Singapore, 1991.

7 M. FERBER, *Poetry and Language – The Linguistics of Verse*. Cambridge University Press, Cambridge, 2019, 86.

8 F. SAUSSURE, *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*, Dituria, Tiranë, 2002, 92.

9 F.J. GRAHAM, *Onomatopoetics, Theory of Language and Literature*, Cambridge University Press, Cambridge, 1992

10 M. FERBER,.*Ivi.*

"Sokrati: Më lejo të të ftoj tani ta marrësh parasysh se çka Hermogjeni dhe unë po thoshim për tingujt. A pajtohesh me mua se shkronja 'rho' është shprehje e rapiditetit, e lëvizjes dhe e fortësisë? Kishim të drejtë apo gabonim kur thoshim ashtu?
Kratili: Më duhet të them se kishit të drejtë.
Sokrati: Dhe se 'lamda' ishte shprehje e lëmueshmërisë, e butësisë dhe të ngjashmeve?
Kratili: Sërish, kishit të drejtë". [11]

Duket se kjo bie ndesh me teorinë e Saussure-it për arbitraritetin e shenjës gjuhësore, ngaqo Saussure i konsideronte onomatopetë dhe pasthirrmat si dy lloje të shprehjes që mund të konsiderohen prova kundër rregullit të arbitraritetit, kurse formacionet onomatopeike thotë se kurrë nuk janë elemente organike të një sistemi gjuhësor[12]. Saussure konsideron se onomatopetë dhe pasthirrmat ose nuk janë realisht pjesë e sistemit gjuhësor ose sistemi i tret shpejt ato. "Pjesërisht si përgjigje ndaj Saussure-it e aribitraristëve dhe pjesërisht për t'i rimenduar hulumtimet ndonjëherë të diskutueshme të kratilianëve të shekullit të nëntëmbëdhjetë, disa linguistë, si Jespersen-i dhe Jakobson-i, kanë ndërtuar një rast për fenomenin e simbolizmit tingullor përtej domenit të ngushtë të onomatopesë".[13]

Esenca e këtyre diskutimeve gjithmonë ka mbetur të qenët e onomatopesë imitim - që në fakt edhe është - imitim i tingujve të natyrës. Në anë tjetër, vetë ideja që tingujt bartin në vete kuptime të caktuara, të paktën te fjalët onomatopeike dhe prejonomatopeike i bën tingujt shumë të rëndësishëm në letërsi – pra, këta tinguj hasen në onomatope dhe pasthirrma – në 'fjalët e çuditshme' të gjuhës.

Ferber-i thotë se mund të ndodhë, gjithashtu, që arbitrariteti dhe sistematika e tingujve të një gjuhe – ku çdo shenjues mund të nënkuptojë çdo të shenjuar, dhe e vetmja gjë që ka rëndësi është që tingujt qartësisht t'i kundërvihen njëri-tjetrit, në mënyrë që një grup i mjaftueshëm fonemash të jetë në dispozicion për të krijuar fjalë nga to - janë pothuajse gjithçka që nevojitet për përdorimet "normale" ose më praktike të gjuhës, të tilla si komunikimi i informacionit, dhënia e urdhrave, bërja e pyetjeve dhe të ngjashme, kështu që kur mendojmë për ato përdorime, vështirë se mendojmë për onomatope ose për simbolizëm tingullor. Mirëpo, thotë Ferber-i: "Sido që të jetë, poetët duket se i përkasin shkollës natyraliste, ose të paktën përpiqen ta bëjnë gjuhën e tyre poetike për ta shprehur natyrën e vërtetë të gjërave. Pothuajse të gjitha diskutimet për onomatopenë në

11 PLATO, *Cratylus*, përkthyer nga Benjamin Jowett. Independently published, March 7, 2020, 7.

12 F. SAUSSURE, Kurs i gjuhësisë së përgjithshme, Dituria, Tiranë, 2002, 92.

13 M. FERBER, *Poetry and Language – The Linguistics of Verse.* Cambridge University Press, Cambridge, 2019, 93.

letërsi citojnë vargjet e famshme të Alexander Pope-s nga "Ese mbi kritikën".

'Tis not enough no Harshness gives Offence,
The Sound must seem an Eccho to the Sense.
Soft is the Strain when Zephyr gently blows,
And the smooth Stream in smoother Numbers flows
But when loud Surges lash the sounding Shore,
The hoarse, rough Verse shou'd like the Torrent roar.
When Ajax strives, some Rock's vast Weight to throw,
The Line too labours, and the Words move slow;
Not so, when swift Camilla scours the Plain,
Flies o'er th'unbending Corn, and skims along the Main.

Duke e analizuar këtë poezi, në këtë kuptim, Ferber-i thotë s 'tTingulli duhet të duket si një jehonë, si reflektim, pasqyrim për kuptimin, thotë Pope: poeti duhet ta bëjë lexuesin ose dëgjuesin të ndiejë se ai ose ajo dëgjon rrymën ose valën, ose punën e Ajaksit. Nuk është e qartë nëse Pope vërtet ka imituar tingujt ose shpejtësinë e subjektit të tij apo vetëm na ka shtyrë të mendojmë kështu. Sibilat për Zefirin dhe përroin kanë për qëllim të evokojnë shushurimën e një flladi ose rrjedhën e qetë të një përroi, por mbizotërojnë edhe tingujt aliterues 'l' dhe 'r', që në atë çift zakonisht mendohet të jetë e butë e mirë dhe e lëngshme. Ferber-i analizon mbi këto pikëpamje edhe poezitë e Hopkins-it e sidomos në sonetin e Rimbaud-it "Voyelles" dhe te bashkëkohaniku i tij po francez Mallarmé.[14]

Nga sa u tha më lart del se poezia i eksploaton më shumë dhe më intensivisht onomatopetë, jo vetëm si primitiva (fjalë të parme), por edhe si fjalë me temë mbi to, por ky lloj fjalësh është i pranishëm në të gjitha zhanret letrare, duke nisur që nga letërsia për fëmijë, ku marrin edhe misionin didaktik të mësimit të gjuhës deri te letërsia për të rritur, letërsia popullore etj., ku ato edhe gjejnë manifestimet e tyre më të qëndrueshme.

1. Figurat e tingullit

Në kuadër të ndarjes së figurave në: figura fonetike, figura leksikore, figura semantike, figura të fjalës, figura të fjalisë[15], onomatopeja ka gjetur vendin e saj. Imitimi i tingujve, i zhurmave, e i zërave të ndryshëm të realitetit objektiv nëpërmjet përsëritjes krijon figurën e onomatopesë, e cila bën bashkë dy aspekte - atë dëgjimor me aspektin pamor, të cilat, pra, tek onomatopeja dalin ekuivalente, duke bërë që situata e paraqitur, veçanërisht përshkrimi i pamjeve, jo vetëm të imagjinohet e të përjetohet si imazh, por edhe të dëgjohet. Sipas Graham,-it, katër janë funksionet

14 *Po aty*., 96-102.

15 Z. RRAHMANI, *Teori e letërsisë* (Botim i dytë i plotësuar) Faik Konica, Prishtinë, 2008, 88.

kryesore të onomatopesë:

1. Të pasurojë përmbajtjen e tekstit, duke dhënë një përshkrim më të gjallë të mjedisit;

2. Të rrisë shkallën e muzikalitetit, pasi onomatopetë janë fjalë që imitojnë tingujt natyrorë;

3. Të thellojë përshtypjen e lexuesve ndaj mesazhit, sepse onomatopeja e bën pamjen 'të dëgjueshme";

4. Të maksimalizojë realitetin e situatës në mënyrë që lexuesit të mund të përjetojnë ndjesi akustike reale të të gjithë pamjes.[16]

Së këndejmi, përdorimi mjaft i dendur i onomatopeve dhe i pasthirrmave krijon një sërë përftesash stilistike, duke na paraqitur një tablo reale të botës së jashtme dhe të asaj shpirtërore, thotë Graham-i, i cili duke folur për onomatopenë në letërsi thotë se "fjalët onomatopeike veprojnë si të dhëna dëgjimore, duke ndezur imagjinatën e lexuesit dhe duke zgjuar shqisat e tij. Këto fjalë ia mundësojnë lexuesit "të dëgjojë" rrëfimin, duke e transponuar cilësinë e përvojës në narrativë të shkruar." Për ta ilustruar këtë ai jep shembuj nga poezia:

The rain tapped gently on the windowpane;
As the wind whispered through the trees,
A symphony of nature's refrain;
Serenading us with melodies.
(Shiu pikëloi butësisht në xhamin e dritares
teksa era vërshëlleu nëpër drurë,
Një simfoni e refrenit të natyrës;
duke na kënduar me melodi)

Në këtë fragment, fjalët "tapped," (pikëloi) "whispered" (vërshëlleu) dhe "melodies" (melodité) krijojnë një rrjedhë muzikore që pasqyron zhurmën e shiut, të erës dhe simfoninë e natyrës. Elementet prejonomatopeike krijojnë një lidhje të fortë midis poemës dhe përvojës shqisore të lexuesit, shpjegon Graham,-i, për të shtuar se edhe në prozë synohen efekte të ngjashme:

She tiptoed through the room, her heart thumping loudly in her chest. The old floorboards creaked beneath her feet, and the clock ticked ominously on the wall. Suddenly, a loud crash echoed through the silence.

(*Ajo hapëroi nëpër dhomë majë gishtash, me zemrën që i rrihte fort në gjoks. Dërrasat e vjetra të dyshemesë i kërcisnin nën këmbë dhe ora trokiste në mënyrë ogurzezë në mur. Papritur, një krismë e fortë jehoi përmes heshtjes*.)

Në këtë fragment proze, fjalët prejonomatopeike si "thumping," "creaked," "ticked," dhe "crash" rrisin tensionin dhe atmosferën në vendngjarje. Lexuesi pothuajse mund të ndiejë trazimin e prekshëm, sikur të ishte

16 F.J. GRAHAM, *Onomatopoetics, Theory of Language and Literature*, Cambridge University Press, Cambridge, 1992.

vetë i pranishëm në dhomë"[17]. NdaaiAi thekson se "onomatopeja shton një shtresë shtesë të aktivizimit të shqisave krahasuar me përshkrimet e thjeshta, duke i bërë ato më angazhuese dhe më të mbajtshme mend.

Ndërsa, Dupriez-i thotë se edhe zhurmat janë onomatope, ndonëse përpjekja për t'i transkriptuar tingujt e natyrës a të ambientit, qofshin ato edhe metaforike, shndërrohet në onomatope nëse ndodh leksikalizimi, përndryshe është vetëm transkriptim i zhurmës: *'Rtststr. A rattle of pcbbles'* (Joyce, Ulysses: 94)[18]. Ndërkaq, vetë onomatopenë e definon si formim i fjalës, tingulli i së cilës imiton sendin e shenjuar: '*Tue crooked skirt swinging, whack by whack by whack*' (Joyce, Ulysses: 48). "*Hark, hark! Bow-wow. The watch-dogs bark! Bow-wow. Hark, hark! I hear The strain of stmtting chanticleer Cry, 'Cock-a-doodle-doo!'* (Shakespeare, The Tempest, 1.2.382-6) [19]

Dupriez-i në këtë kuadër e kornizon edhe mimologjinë, duke e definuar si "imitim i zërit njerëzor apo i shprehisë folëse, apo i shqiptimit të personit[20]. Ai thotë se mimologjitë prodhohen nga tipari i zëshmërisë a mungesës së saj te bashkëtingëlloret, nga gjatësia fonematike dhe nga transkriptimi i zhurmave. Joyce i përzien në tekst tingujt e të ngrënit duke e kujtuar bashkëbisedimin në restorant: *"I munched hum un thu Unchester Bunk un Munchday*" (Uliksi:139).

Një trajtim interesant, Dupriez-i i bën, po ashtu, edhe figurës së harmonisë, të cilën ai e definon si kurdisje e fjalëve në tinguj që synon të imitojë disa zhurma natyrore, si "The moan of doves in immemorial elms/ And murmurinf of innumerable bees (Tennyson, "the Princes", 202-3, sipas Dupriez 1991:207) e plot shembuj të tjerë, kur harmonia tingullore vihet në funksion të tekstit. Kjo domethënë se figurat ku përfshihet efekti tingullor, shkojnë në një mënyrë bashkë me onomatopenë e pasthirrmën.

2. Onomatopeja në letërsinë shqipe

Kështu, nga sa u tha më lart, del qartë se onomatopeja, e definuar si figurë që madje zgjerohet edhe me përfshirjen e figurave të tjera tinguma zënëzë vend të rëndësishëm përgjitsist n nëë letërsi e natyrshëm ee në në letërsinë sasthirrmën.

Do përmendur se në traditën letrare të Kosovës ka pasur ndikim teoria e letërsisë e Milovoj Solar-it, i cili flet për onomatopenë, për aliteracionin

17 *Ibid*., 214.

18 B. DUPRIEZ, *A Dictionary of Literary Devices*, Harvester-Wheatsheaf, New York-London-Toronto-Tokyo-Singapore, 1991, 305.

19 *Ibid*., 310.

20 *Ibid*., 283.

dhe për asonancën, duke i vendosur te figurat e diksionit[21] Po ashtu,edhe Zejnullah Rrahmani i vendos onomatopenë, aliteracionin e asonancën te figurat tingullore. Për onomatopenë në letërsi, Rrahmani thotë se "onomatopeja është figurë e përsëritjes, në të cilën shfaqet përsëritja që ka për bazë imitimin e zhurmave e zërave të natyrës e të qenieve të gjalla. Ky fenomen është mjaft i përhapur në gjuhë, ndërsa kur përdoret në letërsi merr karakter shprehës, duke sjellë atmosferën me të cilën lidhet kuptimi i pjesës[22]. Për ta ilustruar onomatopenë në letërsi, ai sjell vargjet e Kadaresë te poema "Vdekja e Moisi Golemit":

Nën kërkëllime zinxhirësh
Frymëmarrje luanësh
Ulërimë, kuje, lemeri
Gjeneral Mojsi

Sidoqoftë, pavarësisht nga trajtimi teorik-letrar që u bëhet, onomatopeja dhe pasthirrma përdoren gjerësisht në letërsi në disa funksione, por para së gjithash me qëllim ambienture, pra për të krijuar një ambient dhe atmosferë, gjegjësisht sfondin hapsinor, qa e merr me vete lexuesin dhe e dërgon në "vendin e ngjarjes" (onomatopeja) apo krijon efekte psikologjike të bashkëndijimit dhe emocionit (pasthirrma).

Përdorimi i onomatopeve dhe i pasthirrmave në letërsi, siç u pa edhe nga shembujt e përdorur këtu ka disa qëllime. Fillimisht është përfshirja e lexuesit në përvojën e caktuar, duke qenë se fjalët onomatopeike dhe pasthirrmore mund të krijojnë një atmosferë të gjallë dhe përfshirëse. Ato i lejojnë lexuesit të dëgjojnë, të ndiejnë dhe të përjetojnë tingujt e përshkruar në tekst. Pastaj, ka rëndësi edhe transmetimi i tingujve të natyrës për ambienturë, pasi onomatopeja dhe pasthirrma mund të jenë veçanërisht efektive në përshkrimin e tingujve që mund të jenë sfidues për t'u shprehur përmes gjuhës së rregullt. Fjalët si "tik-tak", "tring", "krrau" (onomatope), kërkëllimë, trokitje, gërricje (prejonomatopeike), si dhe 'oh', 'uf', 'ah' (pasthirrma) imitojnë drejtpërdrejt zhurmat që përfaqësojnë, duke e bërë më të lehtë për lexuesit që të vizualizojnë dhe të kuptojnë. I rëndësishëm është edhe ndikimi emocional, pasi fjalët onomatopeike dhe ato pasthirrmore mund të ngjallin emocione ose disponime specifike. Për shembull, përdorime si "bum", "krrap", "medet", "vaj", papritur mund të krijojë ndjenjën e urgjencës ose befasisë, ndërsa një "fësh-fësh", "viu", "hehe", mund të përcjellin një atmosferë më të qetë e relaksuese. Shprehjet onomatopeike e pasthirrmore ndikojnë pozitivisht edhe në memorizimin e tekstit dhe të rrëfimit përmes eufonisë që krijojnë në tekst, bashkë me asonancën e aliteracionin - lidhja e qenësishme midis tingullit dhe

21 M. SOLAR, *Teorija knjizevnosti*. Skolska knjiga, Zagreb, 2005, 73.

22 Z. RRAHMANI, *Teoria e letërsisë*, Faik Konica, Prishtinë, 2008, 90.

paraqitjes së tij mund t'i ndihmojë lexuesit të ruajnë informacionin dhe të krijojnë një përshtypje të qëndrueshme. Kjo zakonisht ndodh me vjershat ritmike për fëmijë, siç u diskutuan më sipër.

Së këndejmi, duke qenë e pamundshme që onomatopeja, përdorimet e funksionet e saj, të trajtohen në të gjitha zhanret letrare dhe në të gjitha tekstet, në këtë trajtesë do të bëhet një vështrim i tyre në poezitë "Vdekja e Nositit" dhe "Gjeniu i anijes" të Lasgush Poradecit, në tregimin "Klithma" të Anton Pashkut, si dhe në "Lumin e Vdekur" të Jakov Xoxës. Përzgjedhja e tillë është bërë me synimin që të përfshihen zhanre (poezi e prozë) e periudha të ndryshme të letërsisë shqipe.

Njëherësh, këto vepra paraqesin korpus të përshtatshëm për analizimin e funksioneve stilistike, semantike dhe fonologjike të onomatopeve, duke qenë se përdorimet e tyre në këto tekste janë qëllimore, pasi autorët kanë përdorur parimin ikonik për t'i zgjedhur dhe kombinuar tingujt, rrokjet a fjalët, në rastin e poezisë edhe këmbët metrike, në mënyrë që ta maksimalizojnë efektin ikonik të tyre.

Ndërsa, analiza është realizuar përmes metodës deskriptive, stilistike e semantiko - funksionale. Kështu, së pari janë identifikuar të gjitha fjalët onomatopeike dhe prejonomatopeike në tekstet e përzgjedhura, më pas janë analizuar struktura e tyre fonologjike, raporti ndërmjet formës tingullore dhe kuptimit, si dhe funksioni që ato kryejnë në organizimin estetik të tekstit. Vëmendje e veçantë i është kushtuar rolit të tyre në krijimin e atmosferës, ritmit, intensitetit emocional dhe efektit evokues... Pra, qëllimi i kësaj trajtese është të analizojë onomatopenë në letërsinë shqipe në planin fonologjik dhe semantik, duke parë se si përdoret, kur e ku përdoret, si shpërfaqet në zhanre të ndryshme, po ashtu çfarë funksionesh stilistike mbulon

2.1. Onomatopeja në "Vdekja e nositit" dhe "Gjeniu i anijes"

Lasgush Poradeci njihet si një ndër poetët shqiptarë që ka përdorur shumë figurat e asonancës dhe aliteracionit, tinguj që, siç u tha edhe më herët, ndonëse nuk janë drejtpërdrejt onomatope apo pasthirrma, bartin në vete diçka nga simbolizmi tingullor dhe ashtu si onomatopetë e pasthirrmat ndihmojnë për të shprehur emocion, gjendje dhe për të krijuar ambienturë.

Vdekja e nositit

Me zjarr ju flas..., me zjarr
Që gjirin t'im kam hapur varr...
Që t'i jap shpresë-edhe t'j-a mar...
Un' ik liqerit zemërak

Fatlum dhe'i pastër si zëmbak,
Po zemra ime kullon gjak:
Se vijnë-urtuar zoqtë-e mi,
Dhe'u jap ushqim me dashuri –
Një dashuri për llaftari:
Pa nis ah! Gjirin t'a godas...
Dh'e hap ah! – gjirin më një ças...
Dh'i nginj ah! zoqtë-e vdes me gas!...
Ahere-helmohet e buçet
Pas mallit t'im liqeri-i shkret.
E rit tallazin posi det.
Ay e tund, ay e shkund,
Ay e hap sa me të mund,
Gjer mun në gjit, gjer mun në fund.
E shpirtin dyke m'a përcjellë,
Më thotë ah! Shih sesa 'sht'i fellë
Ky gjir' i em që të pat pjellë...
...Me zjarr ju flas, me zjarr.

Në poezinë e mësipërme, vibrantet 'r'(gjirin) e 'rr' (zjarr, varr), që mbizotërojnë dy vargjet e para, e krijojnë idenë e lëvizjes (siç thotë Platoni për 'rhota'-n greke) dhe bashkë me tingujt 'z' (zjarr) e 'q'(që) e 'gj' (gjirin), në këtë kontekst sillen si ideofone. Këto siideofone hasen në të njëjtat fjalë duke e dyfishuar efektin ('z' e 'rr' në zjarr; 'gj' e 'r' në gjirin) dhe krijojnë idenë e fonostemave, sikurse tek onomatopetë ku, pra, prania e një grupi tingujsh (një kombinimi fonemash) përsëritet në një numër fjalësh dhe lidhet rregullisht me një kuptim duke formuarn fonostema që krijojnë jo vetëm ambienturën, por edhe njëfarë semantike të caktuara ('sh' e 'll' te 'shllap', 'shllup'). Pastaj, e njëjta ambienturë intensive krijohet ne vargjet:

Një dashuri për llaftari:
Pa nis ah! Gjirin t'a godas...
Dh'e hap ah! – gjirin më një ças...
Dh'i nginj ah! zoqtë-e vdes me gas!...

Ku përsëritja e tingujve 's' dhe 'sh' krijon një ambienturë të lëvizjes dhe të përfundimit, ashtu siç Platoni e përshkruan përmes dialogut ndërmjet Sokratit e Kratilit ngjashmërinë a dallimin ndërmjet 'sklerotes' e 'skleroter' (s/r), por edhe praninë e 'l'-së, ashtu siç në këto vargje qetësia pas vrullit të shprehur me 's' e 'sh' ia lë vendin një qetësie të kobshme shprehur me tingullin 'h' (hap, ah), gjë të cilën Lasgushi e bën edhe te poezia "Gjeniu i anijes", ku dallimi ndërmjet fillimit dhe fundit mbështetet, para së gjithash, në përdorimin e asonancës dhe aliteracionit:

I. Fillimi
Vështroni si shket sipër valash
E tundet anija me nge? –
…Me krismë-e me prush prej stërkalash
Mi të shkrepëtiu një rrufe!…
Ti det, brohori fshehtësire!
Kuptim i potershëm, ti det!

II. Fundi
Valim-i anijes q`u sos.
Valim-i anijes së letë
Qetohet,ndalohet,mbaron
Njeriu i anijes përjetë
Hepohet…anohet…valon…

Vargjet e fillimit janë të vrullshme, me plot lëvizje, ideja e të cilave sillet përmes përsëritjes së tingujve 's' e 'sh' (vështroni si shket sipër valash, krismë, prush, stërkalash, shkreptiu, fshehtësire, potershëm), ndërkohë që fundi vjen i qetë, sjellë përmes përsëritjes së zanores 'a' e bashkëtingëllores 'h' (valim, anijes, qetohet, ndalohet, hepohet, anohet, valon). Këtu gjejmë edhe fjalë prejonomatopeike, si: *shket, krismë, stërkalash, brohori, fshehtësire* etj.që, po ashtu, kanë efektin e vet në krejt ngjarjen.

2.2. **Onomatopeja në "Klithma"**

Në kuptim të prosedeut dhe në kuptim të tablove të përmbysura, poezi e lartanalizuar "Gjeniu i anijes" është e krahasueshme me tregimin "Klithma" të Anton Pashkut, por në rend të përmbysur, pasi në pjesën e parë atje mbretëron qetësia, e reflektuar në tekst përmes asonancës dhe aliteracionit, e cila thuhet me një onomatope dhe pjesa e dytë, ku mbretëron kaosi, po ashtu e shprehur përmes asonancës dhe aliteracionit:

I. Qetësia
Terri u derdh, e një rigë e praruar e rrezeve të hënës e lau kreshtën e malit, luginën dhe u ngrit poshtë, atje mbi syprinën e lëmuar të lumit që rimon buzët dredharake të fushës. Çdo gjë është lidhur e shtrënguar mirë e mirë nga penjtë e qetësisë, nga penjtë e kësaj heshtjeje, e cila është e rëndë, e palëvizshme. Edhe qyqja hesht. As bulku nuk dëgjohet. Çdo gjë është strukur në vetvete, është mbyllur e kyçur në therrën e gjumit. E lart, atje lart nëpër hapësirën e kupës së qiellit, një yll noton duke lënë mbas vetes një hark të gjatë vezullues.

II. Thyerja
Një klithmë u dëgjua!
Korbi krokati.

III. Kaosi
E penjtë e qetësisë u prenë si me shpatë.
Lisat e gjatë, që duken si fantazma të trishtueshme, shushuruan.
Edhe qyqja kukati tri herë. As bulku nuk mbeti pa lëshuar zë.
Kurse hëna ndali rigën e praruar të rrezeve të veta. Ajo u fsheh mbas një reje me skaje të grisura. Nuk desh të shihte krimin, nuk desh të përlyhej nga pikat e gjakut që i lëshonte prerja e korbit.
Një hije, si hije vdekjeje, kaploi vendin.

Në (I) ka mbizotërim të tingujve 'l' e 'll' *(lau, malit, luginën, lëmuar, lumit, e palëvizshme, bulku, mbyllur, lart, qiellit, lënë, vezullues)*, dhe 'h' *(hënës, heshtjeje, hesht, dëgjohet, hark)*, që bashkë me zanoret 'a' dhe 'e' krijojnë një ambienturë qetësie.

Kjo qetësi thuhet në (II) përmes onomatopesh të fuqishme: *Një klithmë u dëgjua!/*

Korbi krokati., ku 'klithma', si fjalë prejonomatopeike e lidhur ngusht tjetër me imitimin e një tingulli të mprehtë e të papritur, ndiqet nga fjala tjetër prejonomatopeike "krrokati**"**, e cila riprodhon zërin e korbit. Ky kapërcim, nga harmonia e tingujve të butë te tingujt e ashpër e shpërthyes, krijon kontrast të dukshëm fonostilistik dhe rrit tensionin emocional të përshkrimit. Një lojë e tillë me onomatope haset edhe te poema **"**Korbi" e Edgar Allan Poe, ku folja "krrokati*"* jo vetëm që jep krrokamën e korbit, por edhe përforcon atmosferën e zymtë të krejt veprës.

"What this grim, ungainly, ghastly, gaunt, and ominous bird of yore
Meant in croaking "Nevermore."

(çfarë ky zog i zymtë, shëmtim, ogurzi, i lig e fodull i së shkuarës
mendon tek krrokat "Kurrë më")

Pra, Në pjesën (III) thyhet qetësia dhe ndryshon përfshirja e tingujve. Mbizotërojnë tingujt 'sh' e 's' (qetësisë, shpatë, lista, trishtueshme, shushuruan, lëshonte, fsheh, desh, shihte) dhe 'r' e 'rr'(prenë, të trishtueshme, shushuruan, tri, herë, lëshuar, kurse, rigën, praruar, rrezeve, reje, të grisura, krimin, përlyhej, prerja, korbit). Gjithashtu, ka përfshirje të fjalëve prejonomatopeike, siç paralajmërohen në momentin e thyerjes (II): të trishtueshme, shushruruan, qyqja, kukati, të grisura.

Ashtu si te poezitë e Poradecit, edhe te tregimi i Pashkut, tingujt bashkohen në funksion fonostemash për të krijuar ambienturë të caktuar, për ta arritur efektin e synuar në mendjen e lexuesit.

2.3. Onomatopeja në "Lumi i vdekur"

Proza shqipe, sidomos ajo e realizmit socialist dhe e realizmit magjik,

karakterizohen nga onomatopeja dhe pasthirrma[23], siç ndodh në romanin "Lumi i vdekur" të Jakov Xoxës. Islamaj që është marrë me leksikun e romaneve të Xoxës, thotë se: "Pasthirrma si pjesë e pandryshueshme e ligjëratës njihet edhe si figurë retorike. Si njësi gjuhësore që shpreh ngjyrim subjektiv, pasthirrma në romanet e Xoxës, shërben për të shprehur drejtpërdrejt ndjenjat e personazheve, në të vërtetë, ajo është shndërruar në përftesë shumë shprehëse.[24]

Në romanin "Lumi i vdekur" mbizotërojn e onomatope me kuptim e përbërje tingullore të konsoliduar, megjithëkëtë ka krijime autentike të autorit, me ç'rast përgjithësisht kuptimi i tyre kushtëzohet nga konteksti dhe në njëfarë forme janë krijime të atypëratyshme. Kjo ka bërë që, Xoxa, duke shfrytëzuar mjete të tilla si shenjat e pikësimit, reduplikimin e rrokjeve a përsëritjen e onomatopesë/pasthirrmës si të tërë, situatat, veçanërisht emocionet t'i bëjë të dalin më intensive e tabloja të bëhet më e gjallë e reale.ë Madje në disa raste, siç është ai me 'oj' dhe 'oj oj', aari të njëjtën përbërje tingullore e përdor ndryshe-ndrysme, në rastin e paren si pasthirrmë dhe e përdet kur shprehet habi para një të papriture ose për diçka jo të zakonshmeet kur qesëndim me dikë a e përqeim dikëet kur shprim kundërshtim për diçka[25]. Kurse në rastin e dytt si onomatope për të shënuar zërin e njeriut kur qan me dënesë[26]. Do përmendur se onomatopeja e së qeshurës, ortografikisht paraqitet në 16 forma: *haha; ha, ha; ha!ha!haaa!; ha, ha, ha; ha…ha…ha…ha; ha-ha-ha; uhaha; uhaha, uhaha; ho-ho; ho!ho!hooo; ho-ho-ho; ohoho; he he*. Këto forma të ndryshme ortografike ndonjëherë janë rezultatë mungesës së konsolidimit, siç është rasti, po e zëmë, me *ha, ha, ha; ha…ha…ha…ha; ha-ha-ha*, kurse në raste të tjera për shkak të ngjyrimeve semantike të ndryshme që bartin, si *he-he*, që, përveç si imitim i së qeshurës, në vete ngërthen edhe ironi. Por ka raste që ortografia bëhet determinuese për dekodimin e kuptimit të një onomatopeje. Shkurtaj, varësisht tingujve që dalin në onomatopetë e të së qeshurës dallon "emetuesin e asaj të qeshure, kështu, sipas tij, ha-ha-ha është imitim i një të qeshure të zgjatur, zakonisht nga burrat, hi-hi-hi është imitim i të qeshurit të zgjatur të ndonjë burri me zë të hollë, kurse ka-ka-ka është imitim i të qeshurit të zgjatur të grave e vajzave dhe, ki-ki-ki është imitim i të qeshurit me zë shumë të hollë të vajzave të reja.[27]

---

23 SH. ISLAMAJ, *Gjuha e Jakov Xoxës*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2000

24 *Ibid.*, 362.

25 Shih: J. THOMAJ, et. al., *Fjalor i Gjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2006.

26 Shih: J. THOMAJ, et. al., *Fjalor i Gjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2006.

27 Gj. SHKURTAJ, *Një vështrim mbi përdorimin e pasthirrmave dhe pjesëzave thirrëse në të folmet e Malësisë së Madhe*, Studime filologjike I, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë,

Ndërsa, Xoxaj përveç tipizimit të emetuesit, përmes formave të ndryshme ortografike shpreh edhe intensitetin e të qeshurës e emocionin e emetuesit ndaj ndodhisëtuPo ashtu, do përmenuar se, në këtë korpus të analizuar, gjegjësisht në "Lumin e vdekur" onomatopetë gjejnë përdorim më të madh se në veprat e tjera - janë shfaqur 48 herë si onomatope primare: *tëk, vap e vup, fap fap/fap, mpap, fit e fit, praf, fshap/ fshap, fshap, mu/ mu-u-uuu, fët-fët/fët, fët e fët,criu-criu fiq, criu- criu fiq/crriuufiiiq, crriu fiq, crriu fiq, fërr...fërr...rr...rr, fllaq-flluq, llapa shup, prram, paf-puf/puf, dë dë dë, grap-grup, gëk, tak, hy...drëë...drëëëë/drrë, drëëë, mpu, gllu-gllu/gllu, gy...gy...gy/ gy...y...y, bëlldum, pllaq, ngëc-ngëc, çu çu, tuaf, kau-gllu-glluk, kau-kau-kau, bram, ty-ty-ty, ga...gu, qapaçup/çapa çup, gam gam, ham ham, ajs ajs, ka, ka, ka...ka, ka, ka, ngak-ngak, fësht-fësht/fësht, përst, ga-ga-ga, brr/brëë-ëë/ bërr...brr...rr rr..., brom, trëng* etj, që tejkalon edhe numrin e onomatopeve të dhëna në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe prej vetëm 14 sosh. Po ashtu, përveç onomatopeve që kanë formë më të konsoliduar e që kanë shtrirje të madhe në përdorim, si ham-ham, fësht-fësht, Xoxa krijon dhe përdor onomatope që nuk janë shumë të rëndomta për tekstet e shkruara, por që kuptohen lehtësisht nga konteksti, të tilla si:

Pastaj, pa hequr sytë nga myzeqarja, bashkoi tok të pesë mollëzat e gishtërinjve të dorës së djathtë, i vuri mbi buzë e u dha një të puthur ***"mpu"*** *në drejtim të Vitës. f.65*

Të tre u nisën vrap ***llapa-shup*** *mbi baltën e madhe, drejt buzës së kënetës, andej nga rënkonte toka. f.341*

Një ***prram*** *e fortë e tytës në direkun e derës e goditi Syleman Tafilin plumb në zemër dhe e rrëzoi në shtrat. f.645*

Qetë myzeqare, ngritur e çmbrehur më të gdhirë, kur Llazit i pat dalë gjumi nga pallma e të vëllait, Kilit të vogël, kishin marrë kallamenë dhe po thyenin e mbllaçitnin me ***"grap-grup"*** *koçanët e thatë të misrit, shkulur me gjithsej. f.54*

"***Criu...criu...fiq...criu...criu...fiq****...". duke i mbajur avaz njëra-tjetrës, u nisën për udhë qerret e myzeqarëve. f.57*

Udhëtuan një copë herë të mirë ashtu ***"ngëc-ngëc"*** *nëpër baltën e rrugës, që po bëhej më e madhe sa më shumë u afroheshin ultësirave të bregdetit. f.66*

Në fjalinë e pestë, është përdorur onomatopeja *criu...criu...fiq...criu... criu...fiq*, e cila është krijim i atypëratyshëm i autorit dhe jashtë kontekstit, nuk do të kuptohej, kurse onomatopetë e tjera si *mpu(q), llapa-shup, prram, grap-grup, ngëc-ngëc* nuk janë të panjohura për përdoruesit e gjuhës shqipe, veçse janë kryesisht tipare të gjuhës së folur.

Potencialin fjalëformues të shqipes Xoxa e shfrytëzon edhe në krijimin e onomatopeve sekondare, pra në krijimin e fjalëve prej temash fjalëformuese onomatopeike, potencial pwr tw cilin ka diskutuar gjerwsisht edhe Angoni

Tiranë, 1972, 122.

mw199[28]. Për shembull:

*Ajo kishte mbërthyer kokën në duar dhe në vesh i buçisnin **"ka...ka...ka-të"** e së Trifonit dhe **"gllu...gllu...gllu-të"** e kaponjve të detit... f. 197*

*"Gjithë buza e kripores u mbush me **"çaf-çaf-et"** e mëllenjave dhe **"qyr-lyk-et"** e qyrylykëve. f. 221*

*"Hë, se s'dëgjon ti, po ec me terezi, se po më tremb rosat me ato **"pllaq plluqet"** e këmbëve të tua si putra ariu." f.285*

Nga shembuj e dhënë më sipër shihet se përgjithësisht nga tema fjalëformuese onomatopeike formohen emra, si: nga onomatopeja *gllu-gllu-gllu*, formohet emri *gllu-gllu-gllu-të*.

Do përmendur se onomatopetë e Xoxës krijojnë pamje të ndryshme të natyrës, në të vërtetë japin pamje tingullore dhe evokuese të saj. Këto njësi gjuhësore kontekstualizohen si onomatope dhe paraqesin tinguj, zëra, zhurmë, klithma, britma të njerëzve, shpendëve, kafshëve, të gjësendeve a fenomeneve natyrore, përveç imitimeve të lartpërmendura, Xoxa përdor onomatope që shoqërojnë a përshkruajnë veprime e akte fiziologjike të njeriut, si imitimi i së qeshurës, të pështyrët, kollitje, puthje, vjellje. Sipas Islamajt, njësitë onomatopeike, të motivuara në pikëpamje fonetike, me raport harmonik në përbërjen e tyre, ndërmjet kuptimit dhe strukturës tingullore, në prozën e Xoxës dalin më shumë ndërthurje estetike… Ato i japin karakter të veçantë organizimit gjuhësor të veprës dhe marrin pjesë në ndikimin e përgjithshëm estetik të strukturës së saj.[29] Po ashtu, Islamaj vëren se onomatopetë "si të tilla janë të lidhura me karakterin esencial të krijimit artistik; ato krijojnë një botë, një botë që shkrimtari e detyron të jetojë edhe përmes shenjave të veçanta gjuhësore që nuk kanë farë kuptimi të mirëfilltë leksikor… një botë shumë evokuese.[30] Përveç neologjizmave të tij, të shumta janë edhe përdorimet e fjalëve prejonomatopeike tashmë të konsoliduara të shqipes, të cilat, njëjtë si vetë onomatopetë, arrijnë t'i ruajnë tiparet më sinjifkante të tyre – t'i japin karakter të veçantë veprës, gjegjësisht gjallëri e intensitet ambienturës:

*Era e detit, marrë nga lart e lart, **shpupuriste** me dorën e lehtë majoket e drurëve dhe mundohej t'i vinte në gjumë. **Guakët**, që pak më parë qenë mbledhur xhumbë në degët e një pishe të thatë, ishin shpërndarë tashmë nëpër drurët **kuriakë** për të kaluar natën. Një boçë pishe, si kishte lëshuar farat e veta, me gjinjët zbërthyer e të ronitur nga vapa, u këput plot zhurmë nëpër degët e drurëve dhe i zgjoi nga gjumi. Vringëllimës së saj metalike i bëri **oshëtimë** rrahja e krahëve të **guakëve** të trembur, që mbushën prapë pyllin*

28 E. ANGONI, *Mundësitë fjalëformuese të tingullimitimeve*, Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve, II, Tiranë, 1989. 803-823.

29 Sh. ISLAMAJ, *Gjuha e Jakov Xoxës*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2000, 357-358.

30 *Ivi*.

*me jetë. Por jeta vazhdoi sa ëndrra. Sërish në pyll ra qetia e parë, e mbushur me **fëshëfërimën** njëshe, si këngë djepi, të halave të pishave, rrahur nga flladi i pagjumë i mbrëmjes. Një trung i madh nisi të shpijë kockat me një **kërkërimë** të vazhdueshme, si t'i ankohej pleqërisë a të mos i mbahej motit. f. 655*

Pra, siç shihet nga shembull i marrë për ilustrim, ku sërish dominojnë emrat prejonomatopeikë, këto përdorime i japin jetë e gjallëri pamjes së përshkruar[31].

Përfundime

Nga analiza e kryer për përdorimin e onomatopesë në letërsinë shqipe, del qartë se kjo figurë tingullore nuk është thjesht një element margjinal, por një mjet i fuqishëm stilistik dhe shprehës. Onomatopeja, përmes imitimit të tingujve të natyrës, zërave të qenieve të gjalla apo fenomeneve të ndryshme, luan një rol të rëndësishëm në gjallërimin e tekstit letrar, si dhe në krijimin e një përvoje të thelluar shqisore për lexuesin. Ajo e afron lexuesin më shumë me botën e përshkruar në tekst, duke e bërë atë të dëgjojë, të ndiejë dhe të përfytyrojë situatat e paraqitura. Tekstet letrare të analizuara, si poezi, ashtu edhe në prozë, dëshmojnë një prani të konsiderueshme të onomatopesë, e cila përdoret me funksione të shumëfishta: për të krijuar atmosferë, për të thelluar emocionin, për të intensifikuar ritmin dhe për të përforcuar mesazhin estetik të veprës. Shembujt nga Poradeci, Pashku dhe Xoxa e dëshmojnë përdorimin kreativ dhe të qëllimshëm të onomatopesë në ndërtimin e kuptimeve dhe ndjesive, por që variojnë varësisht zhanrit, kështu në poezinë e Poradecit dominon funksioni ritmik dhe fonosimbolik, te Pashku onomatopeja shërben si mekanizëm i ndërtimit të tensionit narrativ, te Xoxa vërehet përdorim më i gjerë, përfshirë krijime autoriale dhe potencial fjalëformues.

Gjithashtu, duhet theksuar se konteksti është faktor kyç në interpretimin semantik dhe në kuptimin e onomatopesë, ngaqë, siç u pa,forma e saj shpesh është e pakonsoliduar, ndërsa kuptimi dhe funksioni ndryshojnë në varësi të situatës ligjërimore dhe ngarkesës semantike. Po ashtu, edhe kufiri ndarës mes onomatopesë dhe pasthirrmës, siç u dëshmua te Xoxa, mbetet i lëvizshëm dhe jo i prerë, gjë që e pasuron edhe më tej kompleksitetin dhe potencialin shprehës të këtyre fjalëzave.

Kështu, të gjitha sa u parashtruan, na çojnë në konkludimin se onomatopeja, në të vërtetë, nuk është thjesht një mjet zbukurues e stilistik, por një element thelbësor që kontribuon në ritmin, strukturën dhe efektin emocional të tekstit, duke e bërë atë më të gjallë, më të ndjeshëm dhe më të afërt me natyrën dhe përvojën njerëzore.

31 Për më shumë shih: A. SELMANI, *Onomatopeja dhe pasthirrma në gjuhën shqipe*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2025.

BIBLIOGRAFIA

- Angoni, E. (1989). Mundësitë fjalëformuese të tingullimitimeve, Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve, II, Tiranë, ff. 803-823.
- Black J. Conolly, L., Flint, K., Grundy, I., LePan, D., Liuzza, R., McGann. J., Prescott, A., Qualls, B., Waters C. et.al. (2010) *The Broadview Anthology of British Literature*, Vol.4 – The Age of Romantism-second edition. Broadviewë Press. Toronto.
- Dupriez, B. (1991) *A Dictionary of Literary Devices*, transl. Albert Halsall. Harvester-Wheatsheaf. New York-London-Toronto-Tokyo-Singapore.
- Ferber, M. (2019) *Poetry and Language* – The Linguistics of Verse. Cambridge University Press. Cambridge.
- Graham, F. J. (1992). *Onomatopoetics, Theory of Language and Literature*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Islamaj, Sh. (2000) *Gjuha e Jakov Xoxës*, Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
- Kortvelyessy, L. (2020). *Onomatopoeia – a unique species*?, Studia Linguistica 74, no. 2: 506–551.
- Plato. *Cratylus*. përkthyer nga Benjamin Jowett. Independently published: March 7, 2020).
- Quirk, R., Greenbaum, Si., Leech, G., Svartvik, J., (1985) *A Comprehensive Grammar of the English Language*, Longman, London-New York.
- Rrahmani, Z. (2008) *Teoria e letërsisë*. Faik Konica. Prishtinë.
- Saussure, F. (2002) *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*, Dituria, Tiranë.
- Selmani, A. (2025*) Onomatopeja dhe pasthirrma në gjuhën shqipe*, Instituti Albanologjik, Prishtinë.
- Solar, M. (2005) *Teorija knjizevnosti*. Skolska knjiga, Zagreb.
- Shkurtaj, Gj. (1972) *Një vështrim mbi përdorimin e pasthirrmave dhe pjesëzave thirrëse në të folmet e Malësisë së Madhe*, Studime filologjike I, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë.
- Thomai, J. Samara, M., Haxhillazi, P., Shehu, H., Feka, Th., Memisha, V., Goga, A. (2006). *Fjalor i Gjuhës Shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Wharton, T. (2009) *Pragmatic and Non-Verbal Communication,* Cambridge University Press, London
- Yule, G. (2014) *The Study of Language*, Cambridge University Press, encave e Shqipërisë.